



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ Prot

Tiranë _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (Perfundimtar)

[07.04.2023]

Drejtuar: [“A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk *Numri i NIPT-t* L72230026K *Adresa* Tirane Tirane TIRANE Rruga Reshit Çollaku, pallati i ri tek tregu Çam, Kati i pare, Njesia Administrative nr.10

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mallra
Numri i referencës së procedurës /Lotit: Ref-62534-03-15-2023

Objekti i kontratës: “Blerje Bicikleta për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 34430000-0

Fondi limit: **6,583,333** (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 60 dite kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 26 datë 20 Mars 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X
Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk
Numri i NIPT-t L72230026K

Vlera e ofertes ekonomike: **6,380,000** (gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “ARTEO 2018 shpk *Numri i NIPT-t* L82523203F

Vlera E Ofertes: **5,950,000** (pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ARTEO 2018 shpk *Numri i NIPT-t* L82523203F

Vlera E Ofertes: 5,950,000 (pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të pikës 2, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 3, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara,

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të specifitimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Në përmbushje te kriterit te sipercituar operatori ekonomik “ARTEO 2018” shpk ka paraqitur faturë tatimore elektronike me nr: Kodi / Emri i llojit të faturës: 388 / Faturë tatimore. Numri i faturës: 19/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 05.03.2023 23:08:59.

Komisioni kontrolloi informacionet në lidhje me këtë faturë në Kodin QR te fatures perkatese, nga ku rezultoi se, Statusi i kesaj fature: FISKALIZIMI I SUKSESSHEM, POR KA FATURE KORIGJUESE PER KETE FATURE.

Fatura korigjuese eshte fatura me nr. 20/2023 date 06.03.2023 me ane te se ciles eshte anuluar fatura me te dhena: *Numri i faturës: 19/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 05.03.2023 23:08:59.*

Nga sa me siper fatura e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik per permbushjen e kriterit kualifikues 2.3.1 eshte nje faure e anuluar me nje fature korigjuese ku jane bere zbritje te gjithe artikujt dhe e gjithe vlera e fatures.

Duke qene se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dëshmi tjetër për furnizimet te mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pervec fatures se siperpermendur, KVO arrin ne konkluzionin se ky kriter do te konsiderohet i paplotesuar.

Së dyti AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te paraqese katalogun e prodhuesit/prodhuesve , skeda teknike ku te pershkruhen se permbushen specifikimet teknike te mallrave objekt prokurimi ne perputhje me ato te kerkuara nga AK.

Në permbushje te kriterit te sipercituar operatori ekonomik “ARTEO 2018” shpk, ka paraqitur flete nga katalogu i prodhuesit ne gjuhen “Anglisht” te paperkthyer dhe duke qene se ne DST e procedures dhe konkretisht **Seksioni 1: pika 4.5**

Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip	Anglisht
X	

Katalogu i paraqitur nga Operatori ekonomik nuk do te merret ne shqyrtim nga ana e KVO-së pasi nuk eshte paraqitur ne gjuhen e kerkuar nga ana e Autoritetit ne Dokumentat Standarte te tenderit.

KVO sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, pasi kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, **gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si **të papranueshme.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

